



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2022

VENDIM

Nr. 411, datë 04.10.2022

PËR

CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Diamela Goxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; {...}, etj; {...}; {...}, {...} etj; {...}; Akuza: Veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/2, 283/1, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal (kërkesë e seancës paraprake).

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Tiranë, Ornela Naqellari (relatore), Marsela Dervishi dhe Irida Kacerja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Ndhimë për kalim të paligjshëm të kufijve, Falsifikim i dokumenteve, Drejtëm automjeti në mënyrë të parregullt.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Alma Ahmeti, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje; Objekti: Kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve Arta Duka dhe Dritan Hasani.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur {...}; Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 22, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Astrit Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 22, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuzuar: Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR